



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 33 datë 17/05/2018

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI  
6% PËR PERIU DHËN 1-30 PRILL 2018**

Në mbështetje të nenit 29,30/1,31 të Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar me Ligjin 44/2016, datë 21.04.2016, në pikën 6 të Kreut II të Vendimit nr. 955, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, ndryshuar me Vendimin nr.592, datë 18.10.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 955 datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Prill 2018 në total **5 (pesë)** familje, me fond total prej **23760 (njëzetë e tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë)** lekë. Konkretisht:

**PËR BANORËT E QENDRËS SË BASHKISË ROSKOVEC**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Prill 2018 **2 (dy)** familje, me një fond **10080 (dhjetë mijë e tetëdhjetë)** lekë.

**PËR BANORËT E NJESISË ADMINISTRATIVE STRUM**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Prill 2018 **1 (një)** familje me një fond **5760 (pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë )** lekë.

**PËR BANORËT E NJESISË ADMINISTRATIVE KUMAN**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Prill 2018 **1 (një)** familje, me një fond **3060 (tre mijë e gjashtëdhjetë )** lekë.

**PËR BANORËT E NJESISË ADMINISTRATIVE KURJAN**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Prill 2018 **1 (një)** familje , me një fond **4860 (katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë)** lekë.



Bashkia Roskovec

Prill 2018

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Lindita Vangjel Hoxha		4	Familje në nevojë	5220
2	Miranda Veis Kola		4	Familje në nevojë	4860
	<b>Shuma</b>				<b>10080</b>

Mbyllet me nr rendor 2 (dy)

KRYETAR KËSHILLI

Fletë Goga



FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Felleza Ramadan Ruko		5	Familje në nevojë	5760
	<b>Shuma</b>				<b>5760</b>

Mbyllet me nr rendor 1 (një)

**KRYETAR KËSHILLI**

Eleni Goga



Njësia Administrative Kuman

Prill 2018


FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Ates Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Kujtim Nazif Azizaj		2	Familje në nevojë	3060
	<b>Shuma</b>				<b>3060</b>

Mbyllet me nr rendor 1 (një)

KRYETAR KËSHILLI

Eleni Goga




Njësia Administrative Kurjan  
PRILL 2018

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

NR	Emri Atest. Mbledhës	NR. dosjes	NR. Fyneve	Emri i ndihmës	Shuma
	i Lingua Skënder Lyska		4	Familje në nevojë	4860
	<b>Shuma</b>				<b>4860</b>

Mbyllet me nr rendor i (një)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 34. DATE 17.05.2018

**“PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.73 DATË 24.11.2017“PËR MIRATIMIN E  
PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2018”**

Në mbështetje të ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” neni 54 gërma f, të ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, të Ligjit 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, të VKM nr. 1108 datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të Bordeve Rajonal të Kullimit”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- Miratimin e disa shtesave në Vendimin nr.73 datë 24.11.2017 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2018”, si me poshtë :
- Tarifën e pastrimit për Shoqëritë e kursim kreditit,

	Roskovec	Strum	Kuman	Kurjan
<i>Shoqëritë e kursim kreditit</i>	60 000	30 000	30 000	30 000

- Tarifën për pastrimin e kanaleve të treta kulluese – **50(pesëdhjetë)** lekë/metër linear





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 35. DATË 17.05.2018

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 23, DATË  
20.02.2017, “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË STREHIMIT”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore” neni 24; të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale të strehimit” (i ndryshuar) neni 13; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 29.8.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t'u strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”; urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Roskovec nr. 23, datë 13.03.2018 “Për komisionin e kryerjes së procedurave përkatëse për strehim”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.23, datë 20.02.2017 “Për Krijimin e komisionit të strehimit”, Këshilli i Bashkisë:

**VENDOSI:**

Pika 1 e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.23, datë 20.02.2017, “Për krijimin e Komisionit të Strehimit”, ndryshon si më poshtë:

- 1) Komisioni i Strehimit, pranë Bashkisë Roskovec përbëhet si më poshtë:
  - Isa Hoxha - Zëvendëskryetar
  - Delina Hoxha - Përgjegjëse e lejeve të ndërtimit
  - Elis Apostoli- Përgjegjës i shërbimeve sociale
  - Eleni Gjikonaj- Përgjegjëse e financës
  - Ronada Hoxha – Organizatë jofitimprurëse

**K R Y E T A R**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 36 datë 17/05/2018

**PËR ANULIMIN E VENDIMIT NR.41 DATË 22.05.2017  
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRDORUESVE FAKTIKË TË TOKËS  
BUJQËSORE DHE SUBJEKTEVE PËRFITUES TË CILËT PLOTËSOJNË  
KUSHTET LIGJORE PËR T’I PAJISUR ME AMTP, VENDODHJEN E TOKËS,  
SIPËRFAQEN DHE KUFITARËT PËR CDO NGASTËR”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 9948 datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore “ i ndryshuar, VKM nr.253 datë 6.03.2013 " Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish -kooperativave bujqësore" i ndryshuar, Urdhrit të Kryetares së Bashkisë Roskovec, me Nr. 160 prot datë 11.04.2018 “Për shqyrtimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.41 datë 22.05.2017 “Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore dhe subjekteve përfitues të cilet plotësojnë kushtet ligjore për t’i pajisur me AMTP, vendodhjen e tokës, sipërfaqen dhe kufitarët për cdo ngastër”, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI:**

1. Të anulohet VKB nr.41 datë 22.05.2017 “Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore dhe subjekteve përfitues të cilet plotësojnë kushtet ligjore për t’i pajisur me AMTP, vendodhjen e tokës, sipërfaqen dhe kufitarët për cdo ngastër”
2. Të fillojë nga e para e gjithë procedura sipas legjislacionit në fuqi për 20 familjet bujqësore të kaluara me VKB Nr.41 datë 22.05.2017 “Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore dhe subjekteve përfitues të cilet plotësojnë kushtet ligjore për t’i pajisur me AMTP, vendodhjen e tokës, sipërfaqen dhe kufitarët për cdo ngastër”

KRYETAR

*Elena Gofa*







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 37, date 17/05/2018

"PER NDRYSHIME NE BUXHETIN E BASHKISE PER VITIN 2018"

Ne mbeshtetje te ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne RSH", te ligjit 68/2017 "Per financat e veteqeverisjen vendore", Udhezimi nr.2 date 6.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", i ndryshuar, te VKB nr.76 date 22.12.2017 "Per miratimin e buxhetit dhe numrin maksimal te punonjesve te Bashkise Roskovec per vitin 2018", te ligjit nr. 9232 date 13.05.2014 "Per programet sociale te strehimit , i ndyshuar, te udhezimit nr. 12 date 18.04.2018 "Mbi menyren e aplikimit te njesive te vetqeverisjes vendore per fonde strehimi" , Keshilli i Bashkise;

V E N D O S I:

1. Miratimin e fondit prej 500,000 leke per programet e strehimit per vitin 2018.

Gr.	Tit.	Kap.	Art.	Shuma leke
00	06190	5	606	500,000

2. Ky fond te perballohet nga fondi rezerve I miratuar ne buxhetin e vitit 2018.

Gr.	Tit.	Kap.	Art.	Shuma leke
00	01110	5	604	500,000

K R Y E T A R

Elmi GOGA

